
DEVELOPMENT OF TOURISM IN THE REGION OF PODIJEVO

Kujtim RaciCollege Business, Prishtina, Kosovo, kujtimraci_73@hotmail.com

Abstract: Tourism can be thought of as a cluster of links and phenomena that come as a result of temporary movements and attitudes of traveling people, mainly leisure and recreational purposes. Trips and stances in the host countries, typical for tourism, which can be met by tourism industry companies, dictate requests for various services. Unlike other forms of leisure, tourism sees these movements, attitudes and holidays not only in terms of meeting the needs of tourists but also in terms of their economic and trade aspect.

The research, analysis and studies I have done in the field of tourism management, as well as the experience of working in hotel facilities and the knowledge I possess in the field of tourism, have been an incentive for me to approach a proper theoretical and practical study of tourism management. Bearing in mind that pre-war tourism management has had other management ways and has been less developed after the war despite the major damage caused by war in all sectors of the economy and the transformation of public tourist property into private ones (especially tourist infrastructure), there is insufficient investment in tourism development and management.

One of the main goals has been to advance the procedures and techniques and increase the professional level in the development of tourism and its management.

The research objective has been the linkage and possible application of contemporary tourism management and tourism strategy specifications with tourism management and development in the Republic of Kosovo, as well as in the municipality of Podujevo.

Keywords: Tourism and Tourism Definition. Tourism resource management. Strategic Planning in Tourism Development.

ZHVILLIMI I TURIZMIT NË RAJONIN E PODUJEVËS**Kujtim Raçi**Kolegji BIZNESI – Prishtinë, kujtimraci_73@hotmail.com

Abstrakt: Turizmi mund të mendohet si një bashkësi lidhjesh dhe fenomenesh që vijnë si rezultat i lëvizjeve dhe qëndrimeve të përkohshme të njerëzve që udhëtojnë, kryesisht në kohën e lirë dhe për qëllime rekreative. Udhëtimet dhe qëndrimet në vendet pritëse, tipike për turizëm, të cilat mund të plotësohen nga ndërmarrjet e industrisë turistike, diktojnë kërkesat për shërbime të ndryshme. Në dallim nga format tjera të kalimit të kohës së lirë, turizmi i sheh këto lëvizje, qëndrime e pushime jo vetëm në aspektin e plotësimit të nevojave të turistëve por edhe në aspektin ekonomik dhe tregtar të tyre. Hulumtimet, analizat dhe studimet që i kam bërë në fushën e menaxhimit të turizmit, si dhe eksperiencën e punës në objekte hoteliere dhe njohurit që disponoj në lëmin e turizmit, kanë qenë nxitje për mua ti qasem një studimi të mirëfilltë në aspektin teorik dhe praktik të menaxhimit të turizmit. Duke pasur parasysh se menaxhimi i turizmit para luftimeve ka pasur mënyra tjera të menaxhimit dhe ka qenë shumë pak i zhvilluar, pas luftës përkundër dëmeve të mëdha që ka sjellë lufta në të gjithë sektorët e ekonomisë dhe transformimit të pronës publike turistike në atë private (sidomos infrastruktura turistike), ka investime jo të mjaftueshme në zhvillimin e turizmit dhe menaxhimin e tij. Një ndër qëllimet kryesore ka qenë që të bëhet avancimi i procedurave dhe teknikave si dhe ngritjen e nivelit profesional në zhvillimin e turizmit dhe menaxhimin e tij.

Objektivi i hulumtimit ka qenë ndërlidhja dhe aplikimi i mundshëm i specifikave bashkëkohore të menaxhimit të turizmit dhe strategjisë së turizmit me menaxhimin e turizmit dhe zhvillimin e tij në Republikën e Kosovës, e njëkohësisht edhe në komunën e Podujevës.

Konceptet kyçe: Turizmi dhe definimi i turizmit. Menaxhimi i resurseve turistike. Planifikimi strategjik në zhvillimin e turizmit.

HYRJE

Duke parë rëndësinë e madhe të turizmit, si dhe duke parë trendët e zhvillimit të këtij sektori në vendet e rajonit, Evropës e më gjerë, dhe duke parë vlerat turistike që i ka Kosova, njëkohësisht edhe komuna e Podujevës, si dhe rëndësia e menaxhimit të këtyre vlerave turistike, jam përpjekur që sado pak të kontribuoj në

këtë lëmi, me kusht që në të ardhmen, këto materiale të plotësohen me shënime dhe hulumtime të reja në menaxhimin e turizmit.

Rëndësia e madhe e këtyre vlerave turistike dhe menaxhimi tyre, viteve të fundit ka tërhequr vëmendjen dhe ka zgjuar një interesim mjaft të madh në hulumtimin, ruajtjen dhe avancimin e këtyre vlerave turistike.

Zhvillimi i turizmit në komunën e Podujevës është në proces e sipër, sidomos pjesa e liqenit të Batllavës dhe pjesët tjera malore në të cilat kanë filluar investime private në hoteleri, por, kërkohet nga institucionet komunale një përkushtim dhe investim më i madh në lëmi në ruajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të këtyre vlerave turistike dhe menaxhimin e tyre. Në këtë punim do të prezantohet resurset dhe potencialin turistik si dhe të avancojë praktika më të mira në menaxhimin e turizmit përmes identifikimit dhe menaxhimit bashkëkohor të turizmit.

Komuna e Podujevës sikur edhe tërë Kosova, po kalon një fazë të tranzicionit të shpejtë dhe se e ardhmja premtot shumë në avancimin e vlerave në lëmin e menaxhimit të turizmit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tij, dhe se shumë shpejt do të ketë një interesim dhe tretman më të madh institucional.

1. PËRKUFIZIMI DHE KARAKTERISTIKAT E TURIZMIT

Viteve të fundit zhvillimi i turizmit ka marrë një hov të madh, si dhe është kthyer në një fenomen me karakter shoqëror me të cilin janë të lidhura një mori procesesh. Mund të konkludohet që turizmi është një fenomen shoqëror por, njëkohësisht dhe një fenomen i rëndësishëm ekonomik. Studiuesit e turizmit, për të arritur në një përkufizim i kanë kushtuar vëmendje përpunimit të emëruesve të përbashkët, që e shpjegojnë turizmin në tërësi si dhe karakteristikat e tij. Vështirësi dhe probleme ka pasur në përcaktimin e një përkufizimi që të jetë në të njëjtën kohë si analitik ashtu dhe sintetik. Prania e një përkufizimi të turizmit është e domosdoshme edhe për të pasur një bazë nga ku mund të nisemi për të zhvilluar një sistem turistik. Kohëve të fundit turizmi shëndërrohet në një fenomen tipik i shoqërive, lidhur ngushtë me progresin ekonomik e shoqërorë të vendeve të zhvilluara ekonomikisht. Shkakët kryesore të këtij zhvillimi janë:⁴¹⁴

1. Paqja relative që mbizotëron në këto vite pas luftërave botërore, niveli i lartë i jetës që arriten vendet e industrializuara,
2. Krijimi i kushteve shoqërore për të gjithë shtetasit e popullsisë,
3. Impenjimi i qeverive për progres,
4. Zvogëlimi i shpenzimeve të transportit.

Sa i përket mjeteve të transportit periudha e zhvillimit të turizmit karakterizohet nga përdorimi masiv i avionit, mjeteve detare të lundrimit, trenave të shpejtë, etj. Kështu që turizmi i kësaj faze historike vazhdon të përbëhet në pjesën më të madhe 75% nga turizmi kombëtar dhe një pjesë të vogël prej 25% nga turizmi ndërkombëtar⁴¹⁵. Në këto vite oferta e shërbimeve turistike u shndërrua në një industri të vërtetë. Kemi kështu lindjen e industrive me një cikël që sigurojnë shërbime të agjencive të udhëtimit të transportit dhe të qëndrimit. Çmimet e produkteve turistike janë në ulje të vazhdueshme duke siguruar kështu qetësi dhe siguri për turistët. Ndikimi i vazhdueshëm në jetën moderne, si dhe në lidhje me gjithë efektet që rrjedhin prej natyrës shoqërore e ekonomike, ka bërë që gjatë këtyre viteve të kemi lulëzim të formave të reja të turizmit, si dhe një angazhim më të madh të shtetit në politikën e turizmit dhe në propagandën turistike për të mirën dhe progresin e popujve.

1.1. Përkufizimi modern i turizmit

Turizmi duke qenë një fenomen në ndryshueshmëri e sipër dhe mjaft kompleks, është e domosdoshme që të ekzistoj një përkufizim përfundimtar dhe i vetëm nga ku mund të nisemi për një njohje sistematike e shkencore të tij. Fenomeni turistik ka lidhje me shkencën të ndryshme si ekonominë (për efektet e tij të ndjeshme ekonomike), sociologjinë (për aspektin e tij social), psikologjinë (për kërkimin e motiveve individuale ose të grupit), gjeografinë (për përmbajtjen e tij hapësinore), historinë (për vlerat që ajo bartë në këtë fushë)⁴¹⁶. Në qendër të fenomenit turistik është njeriu. Duke eliminuar dobësitë e përkufizimeve të mëparshme, mund të arrijmë në një përkufizim përfundimtar të turizmit nga pikëpamja më e gjerë e tij dhe më e kuptueshme për të gjitha elementet dhe karakteristikat përbërëse:⁴¹⁷

1. Që të kemi turizëm, duhet të ekzistoj elementi transferim,

⁴¹⁴ Dr. Vjollca Baku, Menaxhimi i Turizmit “Erik”, 2009, fq. 9

⁴¹⁵ www.gtg.webhost.uoradea.ro

⁴¹⁶ Muhaxhiri, Dr. Nexhat Muhaxhiri, Ekonomika dhe menaxhmenti në turizëm, Prishtinë, 2005.

⁴¹⁷ Dr. Vjollca Baku, Menaxhimi i Turizmit “Erik”, 2009, fq. 14

2. Transferimi duhet të shoqërohet me qëndrimin e turistit në një vend, jashtë vendbanimit të tij të zakonshëm,
3. Qëndrimi i tij duhet të jetë i një karakteri të përkohshëm,
4. Qëndrimi minimal i turistit përfshin edhe ekskursionistin, niveli maksimal i qëndrimit është i diskutueshëm dhe ndryshon nga një vend në tjetrin, por kryesorja është që të mos jetë i qëndrueshëm dhe të mos transformohet në një vendqëndrim të përhershëm,
5. Fenomeni turistik përbehet nga dy elemente: subjekti (njeriu), dhe objekti (kapacitetet pritëse turistike),
6. Ndërmjet këtyre dy elementeve duhet të ekzistojë një raport direkt, njeriu duhet ti përdorë pajisjet turistike për tu quajtur "turist".

2. RESURSET KULTURORE E NATYRORE NË ZHVILLIMIN E TURIZMIT NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Bazuar në këto të dhëna mbi kapacitetet turistike që disponon komuna e Podujevës, mund të konkludojm se turizmi në këtë komunë do të lulëzojë dhe do të bëhet akoma edhe më shumë atraktivë për jovetëm për qytetarët e Podujevës, por edhe më gjerë.

Nga kjo që tham më lart, në vazhdim të punimit do të flitet më detalisht mbi historikun e Podujevës, mbi pozitën gjeografike, demografin, mbi planifikimin e resurseve turistike në komunën e Podujevës, etj

2.1. Pozita gjeografike e komunës së Podujevës

Pozita gjeografike Komuna e Podujevës gjendet në veri-lindje të Kosovës. Në aspektin e pozitës gjeografike, komuna e Podujevës shtrihet në Luginën e lumit Llap dhe ofron kushte të mira për kultura të ndryshme bujqësore. Ajo kufizohet me pesë komuna tjera të Republikës Kosovës (Prishtinë, Vushtrri, Mitrovicë, Obiliq, dhe Leposaviq) dhe nga ana verilindore kufizohet me Serbinë. Kjo pozitë e përshtatshme gjeografike i ka mundësuar Podujevës të zhvillojë tregtinë për një kohë të gjatë, sidomos përmes rrugës Lezhë-Nish⁴¹⁸.

Podujeva posedon sipërfaqe prej 633.86 km² (5.8% të sipërfaqes së Republikës së Kosovës). Territori i komunës së Podujevës ndahet në tre pjesë⁴¹⁹:

- Fushëgropa e Llapit - shtrihet prej fshatit Repë në veri dhe në jug deri te fshati Besi-Barilevë, me një gjatësi prej më se 35 km dhe me një gjerësi prej 12-15 km;
- Gryka e Llapit - përfshin territorin prej fshatit Repë deri në fshatin Murgull dhe nga Bellasica deri te Kepi i Uglarit, qe është rreth 14 km gjatësi dhe 14 km gjerësi dhe
- Gallapi i Llapit - shtrihet nga fshati Batllavë e deri në fshatin Metërgoc dhe nga fshati Turuqicë deri ne Keqekollë dhe Koliq.

Në territorin e Komunës së Podujevës, relievi është i larmishëm, përbëhet nga male të shumta, me majën më të lartë që është maja e Albanikut me 1770 metra. Gjithashtu, ajo përmban male si Prugovci, Braina, malet e Turuqicës e Herticës majet e të cilave nuk e kalojnë 1100 metra. Fushëgropa e Llapit e cila ka një gjatësi rreth 31 km ndodhet në mes të vargmaleve të lartpërmendura.

2.4. Menaxhimi i resurseve turistike në komunën e Podujevës

Komuna e Podujevës është e pasur me botë bimore e shtazore, e cila është mundësuar falë relievit të përshtatshëm, temperaturës së duhur dhe burimeve të shumta natyrore që ndihmojnë në krijimin e kushteve për jetë⁴²⁰. Burimet natyrore ku për nga bukuria, atraktiviteti dhe cilësia kanë ndikim në zhvillimit të turizmit në Komunën Podujevës mund ti cekim:

- a. Liqeni Artificial i Batllavës,
- b. Lumi Llap,
- c. Banja e Sallabajës,

2.4.1. Liqeni i Batllavës

Liqeni i Batllavës është liqe i cili begaton bukuritë natyrore të rajonit të Podujevës. Uji i liqenit është i destinura për pije dhe për nevojat e korporatës energjetike të Kosovës. Liqeni i Batllavës është atraktiv edhe për zhvillimin e turizmit në rajonin e Podujevës. Thellësia e liqenit është 48 metra.

⁴¹⁸ Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal - SZHEL 2016-2018, Komuna e Podujevës, Dhjetor 2015.

⁴¹⁹ Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal - SZHEL 2016-2018, Komuna e Podujevës, Dhjetor 2015.

⁴²⁰ Hoti, Mr. Hamdi, Menaxhimi i projekteve në fushën e mbrojtjes së natyres, Prishtinë, 2011

Në brendi afër pendes pyrgu për lëshimin e kontrolluar të ujit, teprica e ujit zbarkohet arteries së lumit jashtë pendes. Jashtë pendës së liqenit ndodhet objekti i dedikuar i cili përmes pompave bartëse të ujit e dërgon sasinë e ujit në fabrikën e përpunimit të ujit.

Në kuadër të investimeve për zhvillimin dhe përmirësimin e kushteve për zhvillimin e turizmit, në liqenin e Batllavës, fillimisht janë identifikuar vendet më të frekuentuara nga vizitorët në liqen, në bazë të kësaj janë evidentuar gjashtë vende, si më të frekuentuarat nga vizitorët.

Këtyre vendeve, në hyrje iu janë vendosur shenjat identifikuese dhe janë emërtuar si plazhi i parë deri te plazhi i gjashtë. Gjithashtu këtyre plazheve iu janë ndërtuar edhe rrugët me kocka të betonit deri në brendësi të plazheve, të cilat rrugë iu kanë ndihmuar vizitorëve të kenë qasje më të lehtë në plazhe. Këto tabela iu kanë lehtësuar vizitorëve të orientohen më lehtë se cilin plazh do ta vizitojnë.

Gjithashtu është bërë edhe ndërtimi i kanos për barka. Ajo është ndërtuar prej qeliku dhe ka një sipërfaqe prej 30 m². Kjo kano mund të shfrytëzohet edhe për organizimin e garave të ndryshme si: noti, garat me barka etj.

Në kuadër të programit për zhvillimin e turizmit janë organizuar edhe trajnime për zhvillimin e turizmit rural dhe trajnime praktike për përgatitjen e ushqimeve për hotelet, bujtinat dhe restaurantet të cilat e zhvillojnë aktivitetin e tyre në liqenin e Batllavës.

Po ashtu janë ndërtuar edhe dy vendparksime të plazhi i pestë dhe i gjashtë në sipërfaqe prej 2,600 m².

Liqeni i Batllavës, është liqeni më i vizituar me shkallë përdorimi për rekreacion dhe turizëm në Kosovë. Relievi përreth këtij liqeni është i butë i vegjetuar me bimë të larta drunore, gjetherënëse dhe halore.

2.4.1.1. Pozita gjeografike e liqenit

Kompleksi i Liqenit të Batllavës shquhet për bukuritë natyrore të gërrshëtuara nga liqeni, pyjet dhe peisazhi që e rrethon me sipërfaqe prej 220 km². Pyjet të cilat e rrethojnë liqenin arrijnë lartësinë mbidetare prej 800 – 1000 m. Liqeni i Batllavës paraqet një vend mjaftë atraktiv për zhvillimin e ekoturizmit. Liqeni është krijuar artificialisht në vitin 1965⁴²¹.

2.4.1.2. Plazhet në liqenin e Batllavës

Në Liqenin e Batllavës janë të ndërtuara gjashtë plazhe. Plazhet e ndërtuara janë financuar nga Komuna e Podujevës dhe nga donacionet e Bashkimit Evropian.

Në këto plazh janë investuar afër 376 mijë euro, nga të cilat 326 mijë të investuar nga BE-ja, gjegjësisht Komisioni Evropian, ndërsa rreth 50 mijë euro janë investuar nga Kuvendi Komunal i Podujevës.

a. Plazhi i parë

Ofron vende për pushim familjar, si dhe pushim me shoqëri. Ky plazh posedon ulëse për pushim.

b. Plazhi i dytë

Ofron vende për pushim familjar, si dhe pushim me shoqëri. Ky plazh posedon ulëse për pushim, vendin për kampshtëpiza si dhe vendin për ngritjen e tendave.

c. Plazhi i tretë

Ofron vende për pushim familjar, si dhe pushim me shoqëri. Ky plazh posedon ulëse për pushim, vendin për kampshtëpiza si dhe vendin për ngritjen e tendave.

d. Plazhi i katërtë

Ofron vende për pushim familjar, si dhe pushim me shoqëri. Ky plazh posedon ulëse për pushim, fushën për basketboll si dhe këndin e lojrave për fëmijë të mitur.

e. Plazhi i pestë

Ofron vende për pushim familjar, si dhe pushim me shoqëri. Ky plazh posedon ulëse për pushim, vendin për kampshtëpiza, vendin për ngritjen e tendave si dhe barkat.

f. Plazhi i gjashtë

Plazhi i gjashtë ka një sipërfaqe prej 7000 m² me rërë lumi, pastaj janë vendosur 45 qadra (ombrella) të punuara nga druri me nga dy shtretër. Janë vendosur rreth 40 ulëse druri, është ndërtuar trotuari brenda plazhit, janë vendosur dritat për ndriqim të plazhit, janë ndërtuar dy fusha sportive me rërë, njëra për volejbol kurse tjetra për futboll si dhe janë ndërtuar rreth 350 ulëse për spektatorë⁴²². Është ndërtuar edhe topogani rreth 6 metra i cili përdoret nga fëmijët e vegjel. Plazhi gjithashtu e ka edhe vendparkimin.

⁴²¹ Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal - SZHEL 2016-2018, Komuna e Podujevës, Dhjetor 2015.

⁴²² Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal - SZHEL 2016-2018, Komuna e Podujevës, Dhjetor 2015.

2.4.1.3. Aktivitetet në liqenin e Batllavës

Në Liqenin e Batllavës organizohen aktivitete të ndryshme nga lëmia e sportit, si p.sh. garat në not, garat në peshkari, garat në futboll në rërë. Gjithashtu në liqen organizohen edhe ekskursione të shkollave fillore dhe të mesme.

- a. Garat e peshkatarisë në Liqenin e Batllavës
- b. Futbollit në rërë në plazhin e gjastë
- c. Ekskursione të shkollave fillore dhe të mesme

2.4.1.4. Gastronomia dhe ushqimi karakteristik

Në Liqenin e Batllavës shërbehen ushqime të ndryshme si:

- a. Tradicionale (flia, pite, specat me mazë, lëngë shtëpie, djath etj),
- b. Peshku (klen, babushk, sharan, trofta, shtuka, gërgeq etj),
- c. Skara (mish viqi, mish i bardhë, mish qingji, qebapa, bërçollë etj)

2.4.1.5. Restaurantet

Në kompleksin e Liqenit të Batllavës janë ndërtuar një numër i madhe i restoranteve të ndryshme të cilat e zhvillojnë aktivitetin e tyre duke iu ofruar shërbimë profesionale vizitorëve të kompleksit.

1. **Restaurant Adriatiku** gjendet buzë bregut të Liqenit të Batllavës (afër plazhit të katërtë), posedon terracë dhe plazh privat me qadra dhe me shtretër, me një shërbim shumë profesional dhe me një pamje të mahnitshme.

2. **Restaurant Mileniumi i Ri** gjendet buzë bregut të Liqenit të Batllavës (në fund të plazhit të katërtë), posedon terracë si dhe sallë me terracë mbi liqen. Specialitetet e peshkut janë ndër shërbimet e veqanta që ofron ky restaurant.

3. **Restaurant Liqeni** gjendet buzë bregut të Liqenit të Batllavës (në breg të plazhit të katërtë), posedon terracë me një shërbim shumë të veçantë dhe pamje të mrekullueshme.

2.4.1.6. Bujtinat

Në kompleksin e Liqenit të Batllavës janë ndërtuar një numër i madhë i bujtinave të cilat ofrojnë shërbime të ndryshme si dhoma gjumi, specialitete nga kuzhina poullore, aktivitete sportive etj.

3. PLANIFIKIMI STRATEGJIK NË ZHVILLIMIN E TURIZMIT NË KOMUNËN E PODUJËVËS

Komuna e Podujevës është e përkushtuar në përmirësimin e jetës së qytetarëve, në zhvillimin e qëndrueshëm, rritjen e mirëqenies sociale dhe ekonomike, ofrimin e arsimit cilësor, zhvillimin e turizmit, promovimin dhe përkrahjen e aktiviteteve kulturore dhe sportive, si dhe administratë efikase. Në këtë drejtim komuna e Podujevës e ka hartuar projektin “Zhvillimi, përmirësimi dhe promovimi i turizmit në Liqenin e Batllavës” të cilin e kam paraqitur më lartë. Gjithashtu ka hartuar edhe “Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal - SZHEL 2016-2018”⁴²³. Gjatë hartimit të këtyre projekteve është përdorur Swot analiza, për të analizuar faktorët relevant të cilët ndikojnë në zhvillimin e turizmit në rajonin e Podujevës.

3.1 Swot analiza

Fuqitë u referohen aftësive të cilat mundësojnë dhe lehtësojnë zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit. Si të tilla, ato janë shumë të rëndësishme sepse fuqia mund të përdoret për shfrytëzimin e të gjitha mundësive, për zbutjen dhe zvogëlimin e dobësive si dhe po ashtu edhe për reduktimin e kërcënimeve. Dobësi mund të quhen mungesat apo deficitet substanciale të cilat e pengojnë rritjen, zhvillimin dhe mbijetesën e turizmit të një vendi apo rajoni. Mundësi janë shanse dhe raste të mira të cilat janë në dispozicionin për funksionimin e zhvillimit dhe rritjes së tyre të mëtejshme.

Kërcënime apo rreziqet paraqesin sfida të jashtëzakonshme, të cilat do të mund të pengonin apo linin prapa një fuqi të identifikuar apo do të mund të përshpejtonin një dobësi të caktuar duke penguar në këtë mënyrë shfrytëzimin e mëtejshëm të mundësive të llojllojshme.

Me poshte do të përmendim disa nga fuqit, dobësit, mundësit dhe kërcënimet të cilat ndikojnë në zhvillimin e turizmit në komunën e Podujevës, perkatesisht në zbatimin efektiv të planit.

Fuqite:

- a. Pozita gjeografike e komunes
- b. Resurset natyrore

⁴²³ Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal - SZHEL 2016-2018, Komuna e Podujevës, Dhjetor 2015.

- c. Fuqia e lire punetore
- d. Interesimi i turistëve vendor dhe nderkombëtar
- e. Kushtet klimatike për zhvillimin e turizmit

Dobesite:

- a. Konkurrenca jolojale
- b. Mungesa e stafit profesional për ofrimin e shërbimeve turistike
- c. Mungesa e financave për financim të projekteve të qëndrueshme zhvillimore
- d. Planifikimi joadekuat i projekteve kapitale

Mundesite:

- a. Zhvillimi i infrastrukturës teknologjike dhe zhvillimin e bashkëpunimit
- b. Zgjerimi i kapaciteteve
- c. Ofrimi i shërbimeve të pagesës me kiste

Rreziqet - Kercnimet:

- a. Kufizimet financiare (normat e larta të interesit nga bankat komerciale)
- b. Mungesa e koordinimit në mes qeverisë lokale dhe qendrore
- c. Mundësia e hyrjes në treg e joprofesionistëve

3.2 Plani strategjik për zhvillimin e turizmit

Planifikimi fillon në një etapë më të hershme se sa zhvillimi i strategjisë së zhvillimit të turizmit. Hapat kryesorë mbi zhvillimin e turizmit në komunën e Podujevës janë:

1. Analiza e zhvillimit të meparshëm turistik,
2. Vlerësimi i rolit të turizmit,
3. Analiza dhe sinteza e të dhënave,
4. Formulimi i politikës dhe i planit turistik,
5. Përcaktimi i strategjisë së zhvillimit,
6. Përpunimi i një programi veprimi.

Duke filluar nga hapi i parë që kërkon një studim paraprak ku specifikohen nevojat për procesin e planifikimit dhe krijimit të grupit që do të punojë. Më pas rëndësi të vecantë i kushtohet vlerësimit të vendit turistik në raport me zhvillimin ekonomik të vendit, ku përfshihen më tej të dhënat që kanë të bëjnë me renditjen e aktiviteteve ekzistuese si dhe potenciale turistike për vendin. Në këtë mënyrë vlerësimi i aktiviteteve ndihmon planifikuesin për përcaktimin e rajoneve që janë me të përshtatshme për zhvillimin e turizmit.

3.3. Plani egzistues

Krijimi i hartave është thelbësorë në planin turistik, dhe përderisa përmbahet elementi i planifikimit, përdorimi i hartave përmes kompjuterit, ku pasqyrohen marrëdhëniet në mes të imputeve në plan dhe komponenteve. Më poshtë do të përmendim disa nga pikat kryesore të planit egzistues, si:

1. Survejimi dhe analiza e imputeve, ku për formulimin sistematik sasior dhe cilësor të një politike turistike është e rëndësishme analiza e imputeve dhe survejimi,
2. Atraksionet e turistëve, ku survejimi dhe vlerësimi i atraksioneve turistike potenciale ekzistuese dhe aktiviteteve të lidhura me to, tregojnë tipin dhe lokalizimin e atraksioneve kryesore e cila përben një imput baze për planin,
3. Shërbimet turistike dhe kërkesa në formulimin e planit turistik, impute të rëndësishme që merren në konsideratë edhe gjatë hartimit të politikës turistike përbejnë tipet e projektuara të zhvillimit, kërkesat ndaj tokës, shërbimet dhe lehtësirat turistike,
4. Pajisjet e transportit dhe shërbimet, tregojnë në përgjithësi përmirsimet e sistemit ekzistues, sikurse komplekset e reja të shërbimeve dhe transportit i shërbimeve zhvillimit të niveleve të projektuara të turizmit.

Gjithashtu, edhe analiza e vlefshmerisë së infrastrukturës tjetër ekzistuese, mbi termat e tipit, zgjerimit, dhe lokalizimit përbejnë një faktor tjetër influencues në formimin e planit.

3.4. Propozimi për planifikim strategjik

Për arritjen e sukseshme në drejtimin dhe zhvillimin e turizmit është esenciale planifikimi i turizmit. Eksperienca e mjaft vendeve ka demonstruar se planifikimi i zhvillimit të turizmit mund të sjellë përfitime dhe ruajtje të tregjeve turistike të kënaqshme sikurse edhe zhvillim të tregjeve në turizëm që janë aq shumë të domosdoshme për ciklin e jetës së destinacioneve turistike. Por, nëse realizohet një proces i plotë planifikimi vetëm për zhvillimin e turizmit, atëherë nëpërmjet analizës, parashikimit dhe vlerësimit të potencialeve ekzistuese do të mund të saktësohen dhe vlerësohen zhvillimet e ardhshme me shumë prioritet, që do të

thotë se rrezultatet e planifikimit do të jene te dukshme dhe vërtet do te ketë zhvillim te turizmit. Procesi i planifikimit është i vështirë ngase kërkon kohe, kërkon investime të larta financiare, por eshte veqanarisht i nevojshem per vendet qe vuajne nga problemet sociale, si dhe qe nuk mund të konkurojnë me vendet e tjera.

Turizmi duhet te jetë një industri e planifikuar, sepse ne rradhë të pare ky sektor mbulon përgjithsisht sektor të ndryshëm te tjerë te shoqërisë dhe ekonomisë. Pa planifikim mund te krijohen përplasjet e padeshiruara dhe të pa pritura. Turizmi është ende një aktivitet relativisht i ri ne mjaft vende. Disa qeveri dhe shpesh dhe sektore private, kanë pak ose aspak eksperience në menyren se si duhet te zhvillohet turizmi. Për vendet qe kanë tashme turizem, planifikimi është shpesh i nevojshem ne ringjalljen e këtij sektori dhe ne ruatjen e mbijetesës se tij. Turizmi duhet te jetë një aktivitet i planifikuar ne nivele rajonale dhe kombëtare. Ne këto nivele, planifikimi është përqendruar ne politikat e zhvillimit turistik, planet e strukturuara, faktorët instuticional dhe ne te tjera elemente te domosdoshem për zhvillimin e turizmit. Kështu ne kuader të planifikimit rajonal, duhet te përgatiten me teper plane të detajuara për tërheqjen turistike, si dhe format tjera te zhvillimit turistik⁴²⁴.

Ne menyre qe zhvillimi i turizmit te jete i qendrushem dhe efikas, propozim planifikimi strategjik i komunes se Podujeves duhet qe te përmban keto elemente si:

1. Hartimi i nje plani zhvillimor nga Ministria e Planifikimit Hapsinor ne nivel qendror dhe harmonizimi i planit komunal me ate qendror,
2. Profesionalizmi i ofruesve sipas sferave te veprimit,
3. Paisja me teknologji bashkohore (neper dhoma, restorante), TV, WiFi, dhe teknologji tjera,
4. Formimi i agjensioneve te medha turistike,
5. Restaurimin e objekteve egzistuese, si dhe ndertimin e objekteve te reja,
6. Investime ne kuadra duke percjellur bashkohoren por njekohesisht duke e ruajtur te kaluaren,
7. Zhvillimi turistik në lidhje me ruatjen dhe mirmbajtjen e burimeve natyrore dhe kulturore te vendit.
8. Integrimi turistik në të gjitha politikat dhe modelet e një vendi ose rajoni, si dhe një lidhje te ngusht midis turizmit dhe sektoreve te tjerë ekonomik.
9. Krijimin e nje kornize të qendrushme instuticionale për nje kordinim efektiv te sektorit privat dhe atij publik, arritjet dhe investimet ne turizmi, etj

PËRFUNDIM

Për një menaxhim të suksesshëm të turizmit, për secilin grup të resurseve turistike, kemi propozuar mënyra dhe projekte në menaxhimin e turizmit.

Komuna e Podujevës ka pasur ngecje të mëdha në të kaluarën në menaxhimin e turizmit dhe të projekteve të tilla në mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore dhe se janë hartuar dhe implementuar shume pak projekte investive. Këto probleme janë trashëguar për shumë vite dhe kur kësaj i shtohet edhe fakti se resurset turistike janë dëmtuar në mase të madhe në luftën e fundit, është dashur një kohë e gjatë për rregullimin dhe revitalizimin e tyre.

Komuna e Podujevës gjatë këtyre viteve ka pasur një stagnim të zhvillimit të këtyre vlerave dhe më pastaj me tendencë të zhvillimit të ngadalshëm të tyre.

Në bazë të analizës së përgjithshme të gjendjes së resurseve turistike dhe menaxhimit të tyre në Komunën Podujevës, konkludojmë se resurset turistike dhe menaxhimi i tyre është ballafaquar një kohë bukur të gjatë me probleme të natyrave të ndryshme, siç janë:

- Mungesa institucionale lokale dhe qendrore në ruajtjen dhe mirëmbajtjen e resurseve natyrore dhe kulturore dhe menaxhimin e tyre,
- Mungesa e mjeteve financiare për investime në projekte të tilla,
- Mungesa e stafit profesional në menaxhimin e resurseve turistike,
- Mosdefinimi i pronësisë së resurseve turistike për një menaxhim instuticional,
- Mungesa e komunikimit dhe mos definimi i kompetencave në mes të institucioneve lokale dhe qendrore në ruajtjen dhe menaxhimin e resurseve turistike,
- Dëmet e mëdha të shkaktuara gjatë luftës në objektet me vlera turistike,
- Ndërtimi i objekteve hoteliere pa kritere duke mos u bazuar në rregulloret për funksionimin e tyre të rregullte,
- Konkurrencë jo reale dhe e pa kontrolluar në mes objekteve turistike dhe hoteliere,

⁴²⁴ Gorica, Dr. Klodiana, Vela, MA. Fiorabla, Strategjia e turizmit, Tiranë, 2007

- Komunikimi dhe bashkëpunimi i dobët në mes të institucioneve dhe komunitetit, etj.

Mirëpo në vitet e fundit mund të thuhet se vrehet një lëvizje pozitive dhe një frymë e re institucionale dhe e komunitetit në menaxhimin e turizmit, ku mund të themi se është si rezultat i interesimit dhe vetëdijesimit institucional, vetëdijesimi i komunitetit, trajnime dhe seminare të mbajtura, donacionet nga donatorë të ndryshëm për projekte dhe investime në ruajtjen e resurseve turistike e natyrore dhe menaxhimin e suksesshëm të tyre.

Në këtë kontekst vlenë të cekën vendimet e fundit të institucioneve qendrore (ministrive përkatëse) në ruajtjen e resurseve turistike dhe zhvillimin bashkohorë të tyre, si:

1. Ndalimi i shfrytëzimit të mbeturinave inerte në lumejtë e Kosovës me qëllim të ruajtjes së lumejëve, shtratit të tyre dhe mjedisit nga degradimet dhe dëmet që u janë bërë viteve të fundit.
2. Vendimi mbi obligimet e objekteve hoteliere, që të rexhistrojnë vizitorët që shfrytëzojnë akomodimin, në sistemin online “E-Turizëm”. Ky softuer do të dërgojë të dhënat elektronike në Ministrinë e Tregëtisë dhe Industrisë dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme.

REKOMANDIME

Në bazë të studimeve të bëra në punimë konstatohet se:

- Komuna e Podujevës ka mjaftë resurse dhe potencial turistik për një zhvillim të qëndrueshëm dhe stabil të turizmit.
- Kërkohen plane dhe projekte të të gjitha niveleve dhe investime financiare në implementimin e tyre, në ruajtjen dhe menaxhimin e turizmit.
- Kërkohet të hartohet nga ekspertet e të gjitha larmive një planë strategjik i zhvillimit të turizmit në Komunën e Podujevës.
- Nga rëndësia e madhe ekonomike që ka zhvillimi i turizmit për Komunën e Podujevës, menaxhimi i resurseve turistike duhet të radhitet në prioritetet e qeverisë lokale.
- Të ngritët niveli i bashkëpunimit institucional me komunitetin në vetëdijesimin në mbrojtjen dhe menaxhimin e mire të resurseve turistike.
- Në nivelin qendror dhe lokal të kontrollohen më shumë, afarizmi, cilësia dhe higjiena në objektet hoteliere që ofrojnë: fjetje, ushqim, pije dhe shërbime tjera hoteliere.
- Të ndihmohen nga institucionet komunale, pronarët e dyqaneve që kultivojnë zejet e vjetra.
- Të investohet në shkollimin profesional të kuadrove në lëmin e menaxhimit të turizmit, etj.

Një rendësi të veçantë duhet kushtuar në të ardhmen edhe krijimin e kushteve sa më të mira investitorëve të ndryshëm nga jashtë në projekte të veçanta apo të përbashkëta në lëmin e turizmit. Mirëpo, përveq anës financiare nevojitet edhe personel adekuat për t'i përfunduar aktivitetet me njohuri të mira për punët që planifikohen e që duhet kryer në projekte turistike.

Gjithashtu është nevojë e domosdoshme edhe plotësimi i legjislacionit të duhur me ligje dhe akte të tjera nën ligjore duke i harmonizuar ato me direktivat dhe konventat ndërkombëtare, edhe pse Kosova njëkohësisht edhe Komuna e Podujevës, tani ka një infrastrukturë ligjore të qëndrueshme për zhvillimin e turizmit.

Këta faktorë mundësojnë zhvillimin e turizmit i cili ndikon në sferën ekonomike duke prodhuar efekte pozitive, dhe implementimi i suksesshëm i tyre mundëson arritjen e objektivave të planifikuara dhe me këtë edhe progresin e zhvillimit të turizmit dhe arritjen e plotësimit të standardeve kombëtarë dhe ndërkombëtare që i kërkohen vendit në të ardhmen për integritime evropiane dhe shoqata të ndryshme rajonale.

LITERATURA

- [1] Bakiu, Dr. Vjollca, Drejtimi i ndërmarrjeve hoteliere, Tiranë
- [2] Bakiu, Dr. Vjollca, Menaxhimi i turizmit, Tirane, 2009
- [3] Gorica, Dr. Klodiana, Vela, MA. Fiorabla, Strategjia e turizmit, Tiranë, 2007
- [4] Hoti, Mr. Hamdi, Menaxhimi i projekteve në fushën e mbrojtjes së natyres, Prishtinë, 2011
- [5] Muhaxhiri, Dr. Nexhat Muhaxhiri, Ekonomika dhe menaxhmenti në turizëm, Prishtinë, 2005

Burime tjera

- [1] Të dhëna nga enti i statistikës së Kosovës, Prishtinë, 2011
- [2] Udhëzim administrative nr. 17/2010, për klasifikim dhe kategorizimin e objekteve hoteliere, Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë së Kosovës.
- [3] Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal - SZHEL 2016-2018, Komuna e Podujevës, Dhjetor 2015.
- [4] <https://kk.rks-gov.net/podujeve/City-guide/City-Map.aspx>,
- [5] <https://www.google.com>
- [6] www.wikipedia.org
- [7] http://stad.com/index.php?city_id=789511
- [8] <https://commons.wikimedia.org/wiki/File:Batllava.jpg>